



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 89, datë 31.05.2021**

**PËR**

**MARRJEN E MASAVE NDAJ “RAIFFEISEN INVEST-SHOQËRI ADMINISTRUESE E  
FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË  
INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2 dhe pikës 21, si dhe nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 80, 81, 102 dhe 103 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Bazuar në nenin 80, pika 2 dhe nenin 81, pika 1, germa b), të Ligjit nr. 10197 datë, 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, urdhërohet shoqëria “Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a.:**
  - a. Të depozitojë menjëherë në Autoritet dokumentacionin e duhur për marrjen e miratimit të delegimit të funksioneve të shërbimit të marketimit të fondit të pensionit;**
  - b. Të hartojë një procedurë për informimin dhe transparencën ndaj antarëve të fondit të pensionit, për zbatimin e nenit 14, të Ligjit nr. 10197 datë, 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”;**
  - c. Të rishikojë përmbajtjen e kontratave të fondit të pensionit, duke përfshirë rekomandimet sipas raportit të inspektimit;**
  - d. Të njoftojë anëtarët e fondit 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tyre të pensionit, sipas nenit 4, pika 2 dhe 4, të Rregullores nr. 126, datë 07.12.2010 “Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar”;**

- e. Të ketë të detajuar në procedurën e saj operacionale, afatet dhe mjetet e komunikimit, për informimin e anëtarëve në lidhje me ndryshimin e depozitarit të aseteve të fondit;
  - f. Të marrë çdo masë tjetër që lidhet me korrigjimin e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
2. Bazuar në nenin 81, pika 3, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, shoqëria të zbatojë urdhërin e mësipërm duke raportuar në Autoritet brenda datës 30 qershor 2021.
  3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**